



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 25.07.2012
Nr. 0204-847

PËR: Nexhmidin Arifi, Kryetar i Komunës Viti
Skenderbe Hebibi, Kryesues i Kuvendit të Komunës Viti

LËNDA: KËRKESË PËR RISHQYRTIM E LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS VITI, NR.01-013/1395 të pranuar me datë, 25/07/2012

Të nderuar/a


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së, Vendimi nr. 01-013/1395, i Kuvendit të Komunës Viti për Kufizimin e Ofrimit të Shërbimeve të Caktuara Komunale dhe Kushtëzimin e Ofrimit të këtyre shërbimeve me Pagimin e Faturave për Mbeturina dhe Ujë, të datës 09.08.2011, të Kuvendit të Komunës së **KONSTATON** se:

- Kushtëzimet për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve nga ana komunave për kryerjen e obligimeve të tyre ndaj Ndërmarrjeve Publike Komunale nuk ka bazë ligjore dhe si të tilla nuk mund të aplikohen.
- Bazuar në nenin 128 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, Shoqëria aksionare është përgjegjëse për të gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera me tërë asetet dhe pasurinë e saj dhe se askush nuk është përgjegjëse për detyrimet e shoqërisë aksionare vetëm për shkak se është aksionare në këtë shoqëri.
- Kufizimi i shërbimeve nga komuna, për qytetarët, bizneset dhe operatorët ekonomik që funksionojnë brenda territorit të saj, më pagesën e faturave të mbeturinave për Ndërmarrjen Publike Komunale, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 82 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale **kërkon** nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Vitisë që të ndërmarrin veprime konkrete që, Vendimit nr. 01-013/1395, i Kuvendit të Komunës Viti për Kufizimin e Ofrimit të Shërbimeve të Caktuara Komunale dhe Kushtëzimin e Ofrimit të këtyre shërbimeve me Pagimin e Faturave për Mbeturina dhe Ujë, të harmonizohet me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimin të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Me respekt,

Slobodan Petrović
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,



Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Xhevat Bislimi, kryesues i grupit të anëtarëve të kuvendit të
komunës nga PDK.
Drejtorëve të Departamenteve dhe Drejtorëve të Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 25.07.2012
Br. 0204-847

Za: Nexhmudin Arifi, Gradonačelnik Opštine Vitina
Skenderbe Hebibi, Predsedavajući Skupštine Opštine Vitina

PREDMET: ZAHTEV ZA RAZMATRANJE ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE VITINA,
BR.01-013/1395 Primijeno dana, 25.07.2012

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim prema Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kancelarije Premijera i Ministarstva, posle razmatranja zakonitosti odluke br. 01-013/1395, Skupštine opštine Vitina za ograničavanje pružanja odredjenih opštinskih usluga i uslovljavanje nudjenja ovih usluga sa uplatom faktura za smeće i vodu, od dana 09.08.2011, Skupštine Opštine **KONSTATUJE da:**

- Uslovljavanje za nudjenje usluga gradjanima od strane opština za vršenje njihovih usluga prema Opštinskim javnim preduzećima nema zakonsku osnovu i kao takve se ne mogu primenjivati.
- Na osnovu člana 128 Zakona br.02/L-123 o trgovinskim društvima, akcionarsko društvo je odgovorno za sve dugove i druge obavaze sa svim asetima i njenom imovinom i niko nije odgovoran za obavaze akcionarskog društva samo zato što je aksionar u ovom udruženju.
- Ograničavanje usluga od opštine, za gradjane, biznese i ekonomske operatore koji funkcionišu unutar njene teritorije, sa uplatim faktura otpadaka za opštinsko javno preduzeće, je u suprotnosti sa zakonodavstvom na snazi Republike Kosovo.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, na osnovu člana 82 tačka 2 Zakona za lokalnu samoupravu *traži* od Skupštine Opštine/Gradonačelnik Opštine Vitina da preduzme konkretne mere, da Odluka br. 01-013/1395, Skupštine Opštine Vitina za ograničavanje pružanja odredjenih usluga opštine uslovljavanjem nudjenja ovih usluga sa uplatom faktura za smeće i vodu, da se uskladi sa zakonskim dispozicijama na snazi, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za ponovno razmatranje akta.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS-e,

Kopija: *Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-e*
Xhevat Bislimi, predsedavajući grupe članova skupštine
opštine iz PDK
Direktorima uprava i kancelarija
Arhivu MALS-e .

Për: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal / Departamentin Ligjor

CC: Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Vitisë – Skenderbe Hebibi

Kryetarin e Komunës së Vitisë – Nexhmedin Arifi

Kërkesë për vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit nr. 01-013/1395, të datës 21.04.2011, "Për kufizimin e ofrimit të shërbimeve të caktuara komunale dhe kushtëzimin e ofrimit të këtyre shërbimeve me pagimin e faturave për mbeturina dhe ujë", i miratuar nga Kuvendi Komunal i Vitisë

Kërkojmë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, gjegjësisht Departamenti Ligjor, që të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit nr. 01-013/1395, të datës 21.04.2011, "Për kufizimin e ofrimit të shërbimeve të caktuara komunale dhe kushtëzimin e ofrimit të këtyre shërbimeve me pagimin e faturave për mbeturina dhe ujë", i miratuar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, i cili vendim konsiderojmë se është në kundërshtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare nr.02 – L/123 si dhe Ligjin për Ndërmarrjet Publike nr. 03 - L/087.

Vendimi i datës 29.07.2011 i miratuar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, cenon rëndë të drejtat e njeriut, pasi që qytetarëve të Komunës sonë u kështëzohen shërbimet komunale me pagesën e faturave (borgjeve) për mbeturina dhe ujë, ku për grumbullimin e këtyre të hyrave përgjegjëse është Kompania Regjionale për Mbeturina " HIGJIENA" (SHA – Gjilan) dhe Kompania Regjionale e Ujit " HIDROMORAVA" (SHA – Gjilan), ndërsa Komuna (sipas ligjeve të aplikueshme në fuqi) nuk është kompetente për mbledhjen e të hyrave të Shoqërive Aksionare.

Shpresojmë se, kërkesa jonë do të merret në shqyrtim dhe do të ndërmerren veprime ligjore në kompetencë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për shfuqizimin e Vendimit që cenon të drejtat e qytetarëve. (Vendimi nr. 01-013/1395, të datës 21.04.2011 i Kuvendit Komunal – Viti)

20.07.2012, Viti


Kryesues i Grupit të Këshilltarve të PDK-së
Kuvendi Komunal – Viti

Xhëvat Bislimi

HYRESE-ULAZNA-INCOMING			
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA			
QEVERIA E KOSOVES VLADAR KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal			
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije			
Ministry of Local Government Administration			
Data	26.07.2012		
Datum			
Date			
Njësia organizative	Nr. i Lëndës	Shmënjë	Vlera
-III-	0204-847		



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipal Vitina

Në mbështetje të dispozitave nenit 17. shkronja f. lidhur me nenin 58.shkronja g,dhe h. të Ligjit për vetqeverisje lokale Nr.03/L-040 (G.Z e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe bazuar ne dispozitat e nenit 11.par 2.6 shkronja a dhe c të Statutit të Komunës së Vitit Nr 01-013/ 491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë me datë 29.07.2011 miraton këtë ;

VENDIM

PËR KUFIZIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË CAKTUARA KOMUNALE DHE KUSHTËZIMIN E OFRIMIT TË KËTYRE SHËRBIMEVE ME PAGIMIN E FATURAVE PËR MBETURINA DHE UJË.

I

Me këtë VENDIM – përcaktohen dhe specifikohen llojet e shërbimeve Komunale në kuadër të fushës së kompetencave të mëvetësishme të Komunës së Vitisë ,të organeve të administratës Komunale ,me të cilin vendim Kufizohet ofrimi i shërbimeve të caktuara Komunale ,dhe të njëjtat shërbime kushtëzohen me pagimin e faturave (borgjeve) për mbeturina dhe ujë.

II

Kufizimi i ofrimit të shërbimeve të caktuara Komunale ,nënkupton mosofrimin (moskryerjen) e një shërbimi nga drejtorit e administratës komunale ndaj subjekteve të së drejtës (personave fizik dhe juridik), deri në mosërmbushjen respektivisht shlyerjen e pjesërishme të borgjeve ndaj KRM „HIGJENA” SHA Gjilan dhe KRU „ HIDROMORAVA” SHA Gjilan ,për shërbimet e kryera nga këto kompani.

III

Kushtëzimi dhe kufizimi i ofrimit të shërbimeve të caktuara administrative nga organet e administratës Komunale ,do të zbatohet vetëm ndaj subjekteve të së drejtës ndaj të cilve Kompanit publike nga pika 2 e këtij vendimi ,kan shtrirje infrastrukturore dhe ofrojnë këto shërbime (grumbullim të mbeturinave dhe furnizim me ujë)

IV

Organet e administratës Komunale do të kufizojn ofrimin e shërbimeve të caktuara Komunale ,nga fusha e kompetencave dhe përgjegjësi të tyre ndaj personav fizik dhe juridikë shërbime këto që kan të bëjn me ;

- 1- Shërbime administrative që lidhen me dokumentacionin e pronës ,biznesit,tenderët dhe aktivitetet(dokumentacionin) në fushën e ndërtimit,nëse personat fizik dhe juridik që ,shfrytzojn këto shërbime nga pika III e këtij vendimi ,nuk paguajn faturat (borgjet) për mbeturina dhe ujë.**
- 2- Ofrimi i shërbimeve në kuptim të këtij vendimi do tu afrohet të gjithë personav fizik dhe juridik,nëse të njëjtët ofrojnë dëshmi se kan paguar 40% të borgjit të tyre të përgjithëshem në llogari të N.P. nga pika 2 e këtij vendimi.**

V

Shërbimet e kufizuara dhe të kushtëzuara për personat fizik dhe juridik shfrytëzues të shërbimeve sipas kushteve nga pika 4 e këtij vendimido të zbatohen dhe përfshinë;

- 1- Domumentet pronsore,kadastrave dhe gjeodezike**
- 2- Dhënjt e pëlqimeve për ndërrimin edestinimit të tokës**
- 3- Lejet për shfrytëzimin e pronës komunale**
- 4- Taksën për automjetet motorike**
- 5- Lejet e punës për veprimtarit biznesore ,lejet e punës për veprimtaritprofesionale ,dhe lejet përkatëse të parapara me rregulloret Komunale**
- 6- Konkurimet në fondet publike Komunale –tenderët e publikuar nga zyra e prokurimit.**
- 7- Kushtet urbanistike lejet për ndërtim,pranim teknik të objektit ,dhe lejet për demolim (prishje të ndërtimeve)**

VI

Kufizimi i ofrimit të shërbimeve të caktuara administrative nga Drejtorit e AD. Komunale dhe kushtëzimi i ofrimit të këtyre shërbimeve të përcaktuara si në pikën 2 të këtij vendimi,nuk do të zbatohen ndaj personav fizik dhe juridik dhe kërkesave për dokumente zyrtare që rregullojn të drejtat personale statusore si;

a- Qertifikatat nga LAL

- b- Qertifikatat nga LAV
- c- Qertifikata nga LAM
- d- Qertifikatat mbi gjendjen e lirë martesore
- e- Qertifikatat e statusit familjar
- f- Qertifikatat e vendbanimit

VII

Kufizimet e ofrimit të shërbimeve Komunale Administrative, të përcaktuara me këtë vendim, nuk do të zbatohet ndaj personave fizik të cilët janë shfrytëzues të ndihmave sociale nga QPS.

VIII

Pjesë përbërse e këtij vendimi do të jetë lista e shfrytëzuesve të shërbimeve dhe konsumatorëve të KRM „HIGJENA” dhe KRU „HIDROMORAVA” SHA, ndaj të cilve do të zbatohen dispozitat e këtij vendimi mbi kufizimin e ofrimit të shërbimeve të caktuara administrative nga pika 2 dhe 4 e këtij vendimi

IX

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen të gjitha drejtoritë e administratës Komunale ofrues të shërbimeve administrative, ndërsa monitorimin e zbatimit të këtij vendimi do ta bëjë kryetari i Komunës së Vitisë.

X

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe protokollimit zyrtar të tijë.

Më 29.07.2011

Viti

KRYESUESI
Kuvendit të Komunës së Vitisë
Skenderbe Hebibi

